

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE.

Në vijim paraqitet një përshkrim i politikës së programit buxhetor, objektivave dhe produkteve të tyre për vitin buxhetor 2017.

PROGRAMI “MBËSHETJE PËR INDUSTRIJË ”

Qëllimi. Rritja e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve / pajisjeve / instalimeve në fushat e veprimtarisë së MEI-t; Reduktimi i aksidenteve në punë; Eliminimi i rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjëndje në kushte të pa sigurt depozitimi dhe ruajtje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarjeve dhe subjekteve publike në varësi të MEI-t, në dy landfillet në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme nën administrimin e MEI-t dhe në QGTK; Likujdim dhe mbyllje e ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MEI-t duke realizuar transferimin e plotë të aseteve të mbetura nga administrim shtetëror në administrim privat. Nxjtja e interesit të biznesit, për mundësi zhvillimi veprimtari industriale. Rritjen e shkallës së përpunimit në vend i burimeve natyrore me synim rritjen e kontributit në GDP, eksport dhe punësim. Për vitin 2017, objektivat e këtij programi buxhetor janë:

- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspekimin dhe mbikqyrjen, sigurinë në punë dhe për ndërhyrjet e shpëtimit në raste avarish, për monitorimin e inspektimit dhe mbikqyrjes së sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve në fushat e veprimtarisë së MEI-t dhe emergjencat civile.
- Sigurimi i kushteve të domosdoshme për inspekimin dhe mbikqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.
- Rritja dhe përmirësimi i standarteve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme.
- Sigurimi i kushteve për administrimin e dy landfillet në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme nën administrimin e MEI-t.
- Konservimi, likujdimi dhe mbyllja i ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MEI-t.
- Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e lëkurë këpucës, industrisë së bakrit, nikel silikateve dhe kuarciteve si dhe i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin fondet buxhetore në mbështetje të politikave për zhvillimin e industrisë. Fondet e alokuara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 13.1 % të shpenzimeve totale të miratuara për MEI-in për vitin 2017. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se gjatë tetë-mujorit, shpenzimet për këtë program janë realizuar në masën 44 %. Nëpërmjet këtij programi financohen institucionet si AKSEM, ISHTI, QGTK dhe ndërmarjet.

Referuar tabelës së mëposhtme në nivel programi realizimi i shpenzimeve korrente gjatë këtij tetë/mujori të 2017 është 60% dhe i shpenzimeve kapitale është 24 %. Shpenzimet në total paraqiten me një nivel realizimi relativisht të mirë.

04440	Mbeshtetje per Industrine	Plani Vjetor rishikuar 2017	Fakti 8/m 2017	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	247.855	148.09	60%
1.1	<i>Personeli</i>	165.000	106.761	65%
1.2	<i>Operative</i>	82.855	41.329	50%
2	Shpenzime kapitale	200.380	47.767	24%
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	200.380	47.767	24%
2.2	<i>Financim i huaj</i>			
	TOTALI	448,235	195,857	44%

Grafikisht realizimi i planit të shpenzimeve të programit 04440 paraqitet si më poshtë :



Realizimi i shpenzimeve sipas njesive shpenzuese ne program grafikisht paraqitet si me poshte :

Realizimi I fondeve buxhetore në nivel produkti . Në tabelën e mëposhtme paraqitet realizimi i fondeve buxhetore të programit në nivel produkti .

Grupi	Ministria e Energjise dhe Industrise	Kodi	04440
Programi	" Mbeshtetje per Industrine "	Titulli	
Kodi i		Plani i Buxhetit	Fakti 8-mujorit

		2017	të 2017
Rezultatit	Emri i Rezultatit		
A	Standarte të përmirësuar në kuadër të mbikqyrjes së tregut .	161,082	102,139
B	Standarte të përmirësuar në kuadër të rritjes së sigurisë së punës në miniera.	73,740	41,410
C	Standarte të përmirësuar në kuadër të ruajtjes dhe magazinimit të sigurt të kimikateve të rrezikshme.	13,033	4,541
E	Pajime shpëtuese dhe emergjence	3,240	
I	Landfillet e mbetjeve të rrezikshme Fier dhe Vlorë	2,200	
J	Të dhëna të dixhitalizuara	10,000	
D	Objekte të rikonstruktuar	21,000	5,858
M	Mjet transporti	2,500	
N	Sistem monitorimi me kamera	200	
O	Aparatura laboratorike për tregues cilesorë për analiza të naftës dhe gazit	10,000	9,924
R	Paisje zyre	960	798
S	Paisje zyre elektronike dhe elektrike	4,000	
T	Ish ndërmarrje industriale të konservuara	45,480	33,186
U	Zona të rehabilituara	100,000	
Y	Pajisje kompjuterike	800	798
	Totali	448,235	195,857

Lidhur me realizimin e buxhetit të tetë/ mujorit në nivel produkti, më poshtë është evidentuar ecuria dhe problematika e realizimit të produkteve me nivel të ulët realizimi:

Produkti E “Paisje shpëtuese dhe emergjence” është planifikuar të implementohet në 4-mujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2017. Procedurat përgatitore të prokurimit kanë filluar në muajin prill dhe realizimi i produktit është drejt përfundimit.

Produkti I “Landfillet e mbetjeve të rrezikshme Fier dhe Vlorë të mirëmbajtura dhe monitoruara” është në proces. Eshtë lidhur kontrata për përgatitjen e dokumentacionit për nxjerrjen e lejes mjedisore për të vijuar me tej me monitorim sipas kushteve të lejes. Parashikohet të realizohet 4 mujorin e fundit.

Produkti J “Të dhëna të dixhitalizuara” ishte planifikuar të realizohet në 6- mujorin e dytë, pasi fondi për blerjen e këtij produkti ka qënë fond i ngrirë nga Ministria e Financave. Gjithashtu është kërkuar transferim fondi, kërkesa është në proces shqyrtimi.

Produkti L “Objekte të Rikonstruktuar”, është në proces. Rikonstruksioni i depozitave ka përfunduar ndërsa janë në proces prokurimi depozitave harkore dhe objekti njëkatësh. Në mosrealizimin e tij 100% pezullimi i kryerjes së procedurave të prokurimit për dy objektet e tjera(depozitave harkore dhe objekti 1K) me VKM nr 482, dt. 05.07.2017 “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit për vitin 2017”.

Produkti M “Mjet Transporti”, i cili është planifikuar të realizohet në 6- mujorin e dytë, fondi për blerjen e këtij produkti është ende një fond i ngrirë nga Ministria e Financave.

Produkti N “Instalimi i sistemit të vëzhgimit me kamera” është në proces, aktualisht është bërë testimi i tregut dhe hartuar projekti teknik, po vijohet me kryerjen e procedurave të prokurimit të

sistemit të instalimit me kamera të territorit të QGTK, Procesi i prokurimit ka qënë i pezulluar për një periudhë kohe sipas VKM nr 482, dt. 05.07.2017 “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit për vitin 2017”.

Produkti O “Aparatura laboratorike për tregues cilësore analiza të naftës dhe gazit” është realizuar 100%, sipas planifikimit.

Produkti R “Paisje zyre”, është realizuar 100% sipas planifikimit.

Produkti S “Paisje zyre elektronike dhe elektrike” është në proces pasi është kërkuar transferim fondi. Aktualisht po shqyrtohet kërkesa për kryerjen e transferimit.

Produkti T “Konservim i ish ndërmarrjeve industriale ” është në proces pritet te realizohet 100% deri en fund te vitit 2017.

Produkti "U" është në proces. Kanë qënë planifikuar rehabilitimi i territoreve të 5 ish ndërmarrjeve industriale (NPC, Uzina 12, Kombinati Energjitik, Azotiku Fier dhe Ish Sodë PVC), 3 nga të cilat janë realizuar në vitin 2016. Ka përfunduar procesi i tenderimit dhe është lidhur kontrata për rehabilitimin e ish ndërmarrjes Azotikut, Fier dhe Ish PVC, Vlorë. Ky projekt nuk ka filluar akoma të zbatohet për arsye se kontrata me mbikqyrësit u lidh me vonesë për shkak pezullimit me VKM nr 482, dt. 05.07.2017 “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit për vitin 2017”.

REALIZIMI I PRITSHËM I SHPENZIMEVE DERI ME 31.012.2017

04440	Mbështetje për Industrinë	Plani Vjetor rishikuar 2017	Realizimi i Pritshëm 2017
1.	Shpenzime Korente	247.855	247.855
1.1	<i>Personeli</i>	165.000	165.000
1.2	<i>Operative</i>	82.855	82.855
2	Shpenzime kapitale	200.380	200.380
2.1	<i>Financim i brendshëm</i>	200.380	200.380
2.2	<i>Financim i huaj</i>		
	TOTALI	448,235	195,857

Në përgjithësi produktet në këtë program referuar statusit faktik të realizimit paraqiten në nivel të kënaqshëm, ndërkohë përse i përket realizimit të shpenzimeve kapitale paraqesin një nivel të ulët, kjo për arsye se procedurat për realizimin e produkteve kërkojnë një kohë të konsiderueshme duke marre ne konsiderate edhe fondet e ngrira nga Ministria e Financave dhe pezullimin e procesit të prokurimit gjatë procesit të ristrukturimit të MIE.

Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit

“Mbështetje për Industrinë”

ARBEN DHIMA